


REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dt. 05.05.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për raportim të ndihmave shtetërore që i jep komuna brenda vitit.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1 Merita Rama, Kryesuese
 - 2.2 Arta Ismajli
 - 2.3 Kujtim Pllana
 - 2.4 Adlije Trepça
 - 2.5 Xhevrije Halili
3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të raportoj në mënyrë të rregullt për ndihmat shtetërore që i jep komuna brenda një viti, bazuar në Ligjin Nr. 05/L-100 për Ndhmat Shtetërore që konsiderohen si ndihma shtetërore si dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/2020 për ndihmë shtetërore sipas të cilës institucionet dhënëse të ndihmës shtetërore duhet të raportojnë te Departamenti i Ndhmës Shtetërore për secilën ndihmë brenda 15 ditësh nga dita e dhënies së ndihmës së tillë.
4. Dhënësit dhe përfituesit e ndihmës shtetërore janë të obliguar të mbajnë çdo vit të dhëna përkatësisht regjistër për të gjitha ndihmat për 10 vite nga dita e dhënies së ndihmës.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit për Buxhet dhe Financa
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br. 536 / 21

Nr. i lq. / Br. st.

Data: / Datum 12-05-2021

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit prot. Nr. 511/21 dt. 06.05.2021 e lidhur në mes të Komunës së Vushtrrisë Islamic Relief Worldwide, zyra në Prishtinë, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Fisnik Kamberi, Shef i Administratës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtri, caktohet organ mbikëqyrës nga komuna, në projektin "Ofrimi i Shërbimeve Shëndetësore pa pagesë me fokus vizita lehonave dhe foshnjave, personave me nevoja të veçanta, atyre me Covid-19, personave të shtyrë në moshë etj".
2. I lartpërmenduri, duhet të ndërmerr të gjitha masat dhe aktivitetet e mbikëqyrjes së kryerjes obligimeve dhe përgjegjësi nga Komuna dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Prishtinë të përcaktuara në këtë marrëveshje, duke bashkëpunuar ngushtë me përfaqësues të Organizatës Islamic Relief Worldwide, zyra në Prishtinë si dhe stafin shëndetësorë të angazhuar për punë në terren.
3. Organi mbikëqyrës nga pika një (1) e këtij vendimi duhet të mbaj të informuar në çdo kohë Kryetarin e Komunës përmes raporteve me shkrim për ecurinë e implementimit të kësaj marrëveshje.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Islamic Relief Worldwide, zyra në Prishtinë
- Z. Fisnik Kamberi - organ mbikëqyrës
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe nenit 8 të Marrëveshjes Nr. 542/21 dt. 17.05.2021 për Kryerje të Shërbimeve Komunale në Komunën e Vushtrrisë, të lidhur në mes Komunës së Vushtrrisë dhe NPL “Përparimi” SH.A, Kryetari i Komunës më 16.01.2020, merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT MBIKËQYRËS

1. Themelohet komisioni për mbikëqyrje të implementimit të Marrëveshjes për Kryerje të Shërbimeve Komunale në Komunën e Vushtrrisë të lidhur në mes Komunës së Vushtrrisë dhe NPL “Përparimi” SH.A, në këtë përbërje:
 - 1.1 Besim Muzaqi, kryesues i komisionit – Administrata Komunale
 - 1.2 Bajram Ibrahimimi, anëtar - Arsim
 - 1.3 Mentor Hasani, anëtar – Shëndetësi
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të mbikëqyrë zbatimin e Marrëveshjes Nr. 542/21 dt. 17.05.2021 për Kryerje të Shërbimeve Komunale në Komunën e Vushtrrisë, të lidhur në mes Komunës së Vushtrrisë dhe NPL “Përparimi” SH.A që kanë të bëjnë me: shërbimet e pastrimit dhe sigurimit fizik të objekteve të institucioneve publike të komunës në: administratë, arsim dhe shëndetësi, siç është përcaktuar në nenet përkatëse të marrëveshjes.
3. Komisioni, në cilësi të organit mbikëqyrës do të i kushtoj rëndësi mbikëqyrjes në aspektin e cilësisë dhe saktësisë së kryerjes së shërbimeve.
4. Kryesuesi i Komisionit në fund të çdo muaji duhet të paraqes raport me shkrim për shërbimet e kryera dhe dorëzoj në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave për kryerje të pagesave
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi ju dërgohet :

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë.

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br. 558/21

Nr. i sq. / Br. st.

Data: / Datum 19.05.2021

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


1. Lejohet pagesa e faturës numër 12 datë 02.03.2021, në shumë prej 128.00 € (njëqindnjëzetetë euro) në llogari të DPH "Qamëria" në Vushtri, drekë pune e kryetarit me lojtarë të klubit Futbollistik të Vushtrisë.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPublika e Kosovës
KOMUNA E VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN
REPublika Kosovo

Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 4 pika 6 të Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES

1. Me këtë vendim formohet komisioni për vlerësim të pasurisë jo financiare - inventarit në ish objektin e Gjykatës Komunale në Vushtrri në këtë përbërje:
 - 1.1 Nexhat Merovci, kryesues
 - 1.2 Ramiz Maliqi, anëtar,
 - 1.3 Isa Latifi, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë vlerësimin e inventarit që gjendet në ish objektin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, nëse ka ndonjë vlerë dhe mund të tjetërsohet apo është i pa vlerë dhe mund të hudhet gjegjësisht asgjësohet.
3. Komisioni do të hartoj raport me shkrim me rekomandim për kryetarin e komunës lidhur me të gjeturat rreth gjendjes së inventarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPSTINA VUCHITRAN	
02 Nr. / Br	585/21
Nr. i fq. / Bc. si	
Data: / Datum	27.05.2021
VUSHTRRI - VUCHITRAN	

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 9 të Rregullores së MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 67 shkronja "g" të Statutit të Komunës, rekomandimin e komisionit për vlerësim/zhvlerësim të inventarit në Drejtorinë për inspektime që i referohet kërkesës së Shoqatës së Invalidëve të luftës së UÇK-së dega në Vushtri, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet transferimi në formë të dhurimit i inventarit zyrtar të Drejtorisë për Inspektime në Vushtri, Shoqatës së Invalidëve të luftës së UÇK-së dega në Vushtri.
2. Inventari i cili transferohet/dhurohet:
 - 2.1 Dhjetë (10) karrige lëvizëse me barkode: 2590, 2592, 2593, 2596, 2587, 2588, 2599, 2595, 2591, 2665 si dhe
 - 2.2 Gjashtë (6) karrige për vizitorë pa barkode (të bartura nga objekti i vjetër i komunës).
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Inspektime dhe Zyrtari për regjistrim të pasurisë së komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektime
- Zyrtarit të pasurisë
- Arkivit të sekretarisë